

Nr. 2370 prot.

Tiranë, më 22.11.2022

URDHËR

NR. 228 Datë 22.11.2022

**“PËR TARIFAT E DHËNIES SË INFORMACIONIT
(DOKUMENTACIONIT) TË KËRKUAR”**

Në mbështetje të Vendimit nr. 295, datë 20.03.2013 të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e ISHPSHSH-së”, mbështetur në nenin 13, të Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” si dhe Udhëzimit të Përbashkët nr. 12, datë 21.07.2020 ;

URDHËROJ:

1. Tarifat e shërbimit të dhënies së informacionit (fotokopje ose CD) të jenë si më poshtë:
 - a) Deri në 20 fletë informacioni përfitohet pa pagesë.
 - b) Mbi 20 fletë, për formatin A4, pagesa do të 5 (pesë) lekë/fletë.
 - c) Për informacionin e dhënë me CD, pagesa do të jetë 60 (gjashtëdhjetë) lekë/CD.
2. Specialisti përkatës i sektorit, i cili do të përgatisë informacionin e kërkuar, në bashkëpunim me koordinatorin për të drejtën e informimit të institucionit, duhet të përlllogarisë koston totale të informacionit të kërkuar, duke ia vënë në dispozicion edhe kërkuarit/subjektit të interesuar.
3. Me pagesën e tarifës përkatëse nga kërkuari i interesuar, sipas faturës së arkëtimit (të miratuar), në llogarinë e institucionit dhe paraqitjen e mandatit bankar, menjëherë i dërgohet kërkuarit/subjektit të interesuar informacionin (me postë) ose mund ta tërheqi atë dorazi.
4. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinatori për të Drejtën e Informimit, pranë ISHPSHSH-së.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTOR
Eljo Muçaj

